

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Ekonomia dhe Sistemi Ligjor
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla D4
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Mejdi Bektashi
Detajet kontaktuese:	mejdi.bektashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Në këtë lëndë, së pari studentët do të jenë të trajnuar në të menduarit juridik si të nevojshme për analizën e kornizës ligjore të vendimeve ekonomike. Në mënyrë që të arrihet ky qëllim, disa studime rasti do të paraqitet për studentët.</p> <p>Lënda do të përqëndrohet në kuptimin ekonomik dhe ndikimin e transaksioneve të së drejtës civile dhe mbi alternativat e ofruara nga ligji mbi kompanitë për rregullimin e menaxhimit, përgjegjësitë dhe fitimet. Do të vlerësohen kufijtë e biznesit të vendosura nga ligji mbi konkurrencën dhe e drejta penale.</p> <p>Së fundi, lënda ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me aspektet ekonomike dhe ligjore të josolvensës së kompanive dhe për josolvensën dhe falimentimin në përgjithësi.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës është që studentëve të ju ofrohet njohuri mbi marrëdhëniet funksionale në mes të procedurave racionale të marrjes së vendimeve ekonomike dhe rregullativave të ndryshme ligjore të së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare. Studentët do të njihen me metodat e të menduarit ligjor, të nevojshme për të gjetur zgjidhjet e zbatueshme për palët e interesuara. Në këtë lëndë do të prezantohen edhe studime rasti që mbulojnë marrëdhëniet biznesore, negociimin dhe hartimin e kontratave, shanset dhe rreziqet e financimit, aspektet ligjore të strategjive të hyrjes në treg dhe alternativat e ofruara nga e drejta civile, e drejta komerciale dhe ligjin e kompanisë. Qasja ekonomike e analizës të së drejtës do të jetë e fokusuar në të drejtat pronësore, e drejta e detyrimeve, ligji mbi kompanitë dhe konkurrencën, e drejta e josolvensës dhe falimentimit. Në kuadër të</p>

	<p><i>kornizës të së drejtës së josolvencës, theks të veçantë do t'i vihet metodave të ristrukturimit. Do të analizohet rëndësia e etikës së biznesit dhe të së drejtës penale. Rëndësi e veçantë do të jepet ndikimit të rregullativave ligjore, kontratave dhe institutëve të ndryshme ligjore në sjelljen e agjentëve të ndryshëm ekonomik.</i></p> <p><i>Lënda synon t'i përgatis studentët për konsultime të kombinuara ligjore dhe ekonomike për investitorët privat, si dhe për kompanitë, dhe për t'i shoqëruar ata si avokat në të gjitha çështjet ligjore që mund të lindin. Studentët do të jenë të aktivizuar për të punuar me sukses në fushën e ristrukturimit, në mënyrë që t'i ndihmojnë kompanitë t'i përshtaten kërkesave të reja ekonomike për të shmangur ose, nëse është e mundur, për të kapërcyer josolvencën.</i></p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti do të ketë njohuri dhe aftësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Për të kuptuar mundësitë ligjore për të gjithë pjesëmarrësit në proceset ekonomike</i> • <i>Për të kuptuar rëndësinë e rregullativave ligjore të sjelljeve racionale në fushën e menaxhimit të kompanive private apo korporatave</i> • <i>Për të analizuar kërkesat ligjore për ristrukturimin e aktiviteteve biznesore të individëve apo kompanive si dhe për të propozuar metodat më të realizueshme</i> • <i>Për të kuptuar qasjen ekonomike të analizës së normave ligjore</i> • <i>Një pikëpamje dhe analizë ekonomike e sistemit ligjor si tërësi.</i> 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min	15	1.5
Ushtrime në teren			
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	15	75
Përgaditja përfundimtare për provim	5	5	25

Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezantimet ,etj			
Totali			173.5 orë
Metodologjia e mësimëdhënies:	<p><i>Pas ligjëratës hyrëse prej dy orëve, mësimi i modulit do të bëhet përmes ligjëratave prej një ore dhe seminareve po ashtu njëorëshe çdo javë. Lista e materialeve për lexim dhe pyetjeve për seminar do të shpërndahet paraprakisht dhe nga studentët pritet të përgatisin përgjigjet për diskutime në seminare. Do të prezantohen edhe studime rasti me anë të të cilave studentët do të jenë në gjendje t'i kuptojnë rregullativat ligjore sa i përket vendimeve ekonomike.</i></p>		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>20%: Pjesëmarrja në diskutim në klasë. 20%: Gjatë semestrit, ne do të mbulojnë një numër të problemeve. Secili student do të jetë përgjegjës për të përgatitur dhe prezantuar një problem të lëndës gjatë semestrit. Studenti duhet të shkruajë një punim tri deri në pesë faqe (double-spaced, 12-point Times New Roman font, 1" margins) si analizë të problemeve. Studentët do të kenë 10-15 minuta gjatë orës për të prezantuar problemin dhe për t'u përgjigjur në pyetje. Kjo detyrë do të përbëjë 20% të notës së secilit student. 60%: Provimi.</i></p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> <i>Folsom, Ralph H./Gordon, Michael W./Spanogle, John A.: International Business Transactions, in a nutshell.</i> <i>Grundmann, Stefan/Möslein, Florian: European Company Law, Antwerpen, 2007</i> <i>Van den Bergh/ R. Camesasca, P.: European Competition Law and Economics, Sweet & Maxwell, 2006</i> <i>The Blackwell guide to business ethics, Oxford, 2002</i> <i>Gilpin, Robert: Ekonomia politike globale, Tirane, 2009</i> <i>Buchholz, Todd G.: Die te gjalla nga ekonomiste te vdekur, Tirane, 2008</i> 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> <i>Bouckaert, B./De Geest, G: Encylopedia of Law and Economics. http://users.ugent.be/-gde</i> <i>Hit, Michael A./Freeman, R. Edward/Harrison, Jeffrey S.: Handbook of Strategic Management, Blackwell, 2005.</i> 		

	<i>Revistat dhe materialet tjera</i> <i>Journal of International Economic Law</i> <i>International Review of Law and Economics</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Metodologjia e studimeve të rastit, Teoria e vendosjes
Java e dytë:	Transaksionet e së drejtës civile dhe komerciale
Java e tretë:	Çështjet ekonomike dhe ligjore në aspektin e transaksioneve biznesore ndërkombëtare
Java e katërt:	Aspektet ligjore dhe ekonomike të mardhënieve afatëgjata biznesore dhe partneritetit
Java e pestë:	Alternativat e së drejtës së kompanive për menaxhimin, shpërndarjen e detyrimeve dhe fitimit
Java e gjashtë:	E drejta Evropiane e kompanive
Java e shtatë:	Mbrojtja konsumatore bazuar në rregulloret kombëtare dhe të Unionit Evropian
Java e tetë:	E drejta evropiane e konkurrencës
Java e nëntë:	Një pikëpamje mbi të drejtën e josolvencës dhe falimentimit
Java e dhjetë:	E drejta e josolvencës dhe ristrukturimit
Java e njëmbëdhjetë:	Etika e biznesit dhe e drejta penale
Java e dymbëdhjetë:	Aspektet makroekonomike të sistemit ligjor

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p><i>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Vonesa në ligjerata dhe ushtrime;</i> • <i>Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme);</i> • <i>Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimit;</i> • <i>Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale.</i> <p><i>Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kopjimi gjatë provimit ose testit;</i> • <i>Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit;</i> • <i>Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit;</i> • <i>Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi.</i>